

BANKA E SHQIPËRISË  
TËRHEQ NGA  
QARKULLIMI



# BANKA E SHQIPËRISË DO TË TËRHEQË NGA QARKULLIMI:

Kartëmonedhën me vlerë 100 lekë, emetim i viteve 1993, 1994, 1996.

Kjo kartëmonedhë ka të vendosur në pjesën e përparme imazhin e “Luftëtarit Kombëtar”.

Në pjesën e prapme një peizazh malor në qendër të të cilit është një shqiponjë. Në të djathtë ka të shënuar vlerën e kartëmonedhës.

Pjesa e përparme



Pjesa e prapme



# BANKA E SHQIPËRISË DO TË TËRHEQË NGA QARKULLIMI:

Kartëmonedhën me vlerë 100 lekë,  
emetim i vitit 1996.

Kjo kartëmonedhë ka të vendosur në pjesën e përparme imazhin e “Fan S. Nolit”.

Në anën e prapme janë paraqitur pamje nga ndërtesa e Parlamentit të parë Shqiptar (sot godina e Akademisë së Shkencave), stema e Federatës Shqiptare “Vatra” si dhe emblema e gazetës “Dielli” drejtuar nga Fan S. Noli. Në të djathtë ka të shënuar vlerën e kartëmonedhës.

Pjesa e përparme



Pjesa e prapme



# BANKA E SHQIPËRISË DO TË TËRHEQË NGA QARKULLIMI:

Kartëmonedhën me vlerë 200 lekë, emetim i viteve 1992, 1994, 1996.

Kjo kartëmonedhë ka të vendosur në pjesën e përparme imazhin e “Ismail Qemalit”.

Në pjesën e prapme, në qendër ka një shqiponjë në mes të së cilës duket një pjesë e ndërtesës ku u shpall pavarësia e Shqipërisë. Në të djathtë ka të shënuar vlerën e kartëmonedhës.

Pjesa e përparme



Pjesa e prapme






## FAZA E PARË. DERI NË 31.12.2008!

Ato do të vazhdojnë të kenë kurs ligjor, pra të shërbejnë si mjet pagese, **deri në datën 31.12.2008.**

Pas kësaj date ato nuk do të kenë më vlerën e mjetit të pagesës. Me ato nuk do të mund të kryhen më pagesa për blerje, për shërbime apo të tjera qëllime.

Përpiquni që **deri në 31. 12. 2008** këto kartëmonedha **të mos jenë më në portofolin tuaj!**

Po pas kësaj date? Ç'do të ndodhë në 1 janar 2009 me kartëmonedhat e këtij lloji që i kanë mbetur ende dikujt?



## FAZA E DYTË. 01.01.2009 - 31.12.2010!

Ato nuk mund t'ju shërbejnë si mjet për pagesa të ndryshme, në asnjë rast.

Por gjithsesi, nuk humbisni nëse ende keni në shtëpi apo diku të harruara, kartëmonedha 100 lekë, emetim i viteve 1993, 1994, 1996; kartëmonedha 100 lekë, emetim i vitit 1996 dhe kartëmonedha 200 lekë, emetim i viteve 1992, 1994 dhe 1996.

Ju mund t'i këmbeni ato, me kartëmonedha apo monedha të tjera, që kanë kurs ligjor, pra që mund të shërbejnë si mjet pagese.

Deri në 31.12.2010, do të pranohen dhe do të jenë të këmbyeshme, me vlerën e plotë që ato kanë. Pra, përgjatë 2 viteve, në çdo ditë pune, ju mund të këmbeni kartëmonedhat e prerjes 100 lekë, emetim i viteve 1993, 1994, 1996; kartëmonedhat 100 lekë, emetim i vitit 1996 dhe kartëmonedhat 200 lekë, emetim i viteve 1992, 1994 dhe 1996, që ju kanë mbetur.

Asgjë nuk humbet nga vlera e tyre. Ato thjesht nuk mund t'i përdorni për të kryer pagesa.



## KU MUND TË DORËZOHEN DHE NJËKOHËSISHT TË KËMBEHEN KËTO KARTËMONEDHA?

Pranë çdo banke të nivelit të dytë. Gjatë gjithë orarit të tyre, zyrtar të punës. Dhe ajo që është më e rëndësishmja: **pa pagesë!**

Pra, çdokush që i kanë mbetur ende kartëmonedhat e mësipërme, prej 1 janar 2009 deri në 31 dhjetor 2010, mund t'i dorëzojë kundrejt këmbimit në çdo portel banke, në gjithë territorin e vendit.



Nëse pasi keni lexuar këtë fletushkë,  
keni ende diçka të paqartë apo ndonjë  
pyetje për të bërë mund të drejtoheni:  
[public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)  
ose në numrat e telefonit:

Tel.: +355-(0)4-222152;

Faks: +355-(0)4-223558

Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej"  
Nr.1 Tiranë, Shqipëri.

Tirazhi: 10000 kopje

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)